



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Predata Received/Delivered	14. 06. 2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	SKIMSHEK	3067/2021	115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.356/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.356/2021 të datës 30.04.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë, rruga "Dëshmorët e Kombit", Komuna e Suharekes, kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.356/2021 e datës 30.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi vendimi me numër Nr.Ref.77/2021 i datës 02.04.2021, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi është punësuar sipas akt emërimit me numër 73 të datës 13.10.2011, në pozitën "Zyrtar i pranimit/Logjistikës", në Departamentin e Administratës, në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Me datën 02.12.2016, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, ka nxjerrë vendimin me numër Nr:MPJ-ZSP/153/2016, sipas të cilit ankuesin në kuadër të rekomandimit dhe vlerësimeve pozitive të punës dhe nevojës për plotësim të pozitës, e ka transferuar në pozitën "Zyrtar i lartë për çështje politike", me koeficient 8, në Departamentin për Çështje Politike, sipas të cilit vendim ankuesi edhe ka nënshkruar ndryshim plotësimin e akt emërimit me numër Nr.073/2012, të datës 05.12.2016.

Me datën 02.03.2017, Ministri i Punëve të Jashtme, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.89/2017, sipas të cilit, ankuesi është caktuar me gradën diplomatike Sekretar i Parë të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë, Çeki.

Ministrja në detyrë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 16.02.2021, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.Ref:1115/2021, sipas të cilit ankuesi me gradën diplomatike Sekretar i parë ne



Ministrja në detyrë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datën 16.02.2021, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.Ref:1115/2021, sipas te cilit ankuesi me gradën diplomatike Sekretar i parë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë/Çeki, pas përfundimit të mandatit të tij tërhiqet/kthehet nga misioni i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe sistemimi dhe caktimi i vendit të tij të punës duhet të bëhet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Me datën 02.04.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerrë vendimin me numër Nr.Ref.77/2021, sipas te cilit ankuesin pas kthimit nga misioni diplomatik si Sekretar i parë, i cili ka shërbyer në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë/Çeki për nevoja të Ministrisë, e ka sistemuar në pozitën “Zyrtar i lartë për Logjistikë-Divizionin për IT dhe Logjistikë-Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, duke u bazuar në vendimin me numër Nr.1115/2021, të datës 16.02.2021, të Ministres në detyrë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 11.05.2021, e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme. Ndërsa Këshilli me datën 12.05.2021, ka pranuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 2345/2021, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:2156/2021 e datës 30.04.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 02.04.2021; Vendim me numër Nr.Ref 77/2021 i datës 02.04.2021; E-maili zyrtar i datës 06.04.2021; E-maili zyrtar i datës 02.04.2021; E-maili zyrtar i datës 13.04.2021; E-maili zyrtar i datës 13.04.2021; E-maili zyrtar i datës 05.12.2016; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit me numër Nr.073/2012 i datës 05.12.2016; Vendim me numër Nr:MPJ-ZSP/153/2016 e datës 02.12.2016; Shkresë e datës 05.04.2017, Shkrese e datës 30.04.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 11.05.2021; Përgjigja në ankesë e datës 12.05.2021; Akt emërim i ankuesit me numër 73 i datës 13.10.2011; Vendim me numër Nr:MPJ-ZSP/153/2016 e datës 02.12.2016; Vendim me numër Nr.89/2017 i datës 02.03.2017; Vendim me numër Nr.Ref:1115/2021 i datës 16.02.2021; E-maili zyrtar i datës 04.06.2021; Kartela e nëpunësit e datës 03.06.2021; E-maili zyrtar i datës 03.06.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se: vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për sistemim në pozitën si “Zyrtar i lartë për logjistikë”, në Divizionin për IT dhe Logjistikë në Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, është i pa drejtë sepse i njëjti pretendon se pas kthimit nga misioni diplomatik nga pozita si “Sekretar i Parë”, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë/Çeki, është dashur të sistemohet në pozitën si “Zyrtar i lartë për çështje politike”, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ku ka qenë me herët sipas ndryshim plotësimit të akt emërimit të datës 05.12.2016, me numër Nr.073/2012.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se: ankuesi sipas vendimit të datës 02.12.2016, me numër Nr.89/2017, të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me gradën diplomatike “Sekretar i Parë”, është caktuar të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë/Çeki. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se: ankuesi, me datën 02.12.2020, e ka përfunduar mandatin e tij katër (4) vjeçar në mision diplomatik në pajtim me dispozitat e nenit 22 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm, në të cilin thuhet



se : “ *Kohëzgjatja në misionet diplomatike .Përfaqësuesit diplomatikë qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision diplomatik për një periudhë katër (4) vjeçare, ose ndryshe siç kërkohet për të përmbushur nevojat e Ministrisë dhe në diskrecion të Ministrit të Punëve të Jashtme*”, dhe si rrjedhojë i njëjti edhe është sistemuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pozitën “Zyrtar i lartë i logjistikes”, në Divizionin për IT dhe Logjistikë-Departamenti për Financa dhe Shërbime te Përgjithshme, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se pas kthimit nga misioni diplomatik nga pozita si “Sekretar i Parë”, në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë/Çeki, është dashur të sistemohet në pozitën si “Zyrtar i lartë për çështje politike”, në Departamentin për Çështje Politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e jo në pozitën “Zyrtar i lartë për logjistikë”, në Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se: sipas informatave zyrtare te dërguara përmes e-mailit zyrtar të datës 07.06.2021, nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pozita “Zyrtar i lartë për çështje politike”, në Departamentin për Çështje Politike, ne Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk ka qenë pozitë e lirë në këtë ministri, andaj edhe sistemimi i ankuesit është bërë në njërën nga pozitat e lira ekuivalente brenda institucionit të ministrisë, gjë për të cilën Kolegji vlerëson se vendimi me numër Nr.Ref 77/2021 i datës 02.04.2021, i Sekretarit te Përgjithshëm ne Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për sistemimin e ankuesit ne pozitën “Zyrtar i lartë për Logjistikë” ne Divizionin për IT dhe Logjistikë-Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, është vendim i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ngase Ministria e Punëve te Jashtme nuk ka obligim qe të ruaj vendet për nëpunësit civil të cilët emërohen në misione diplomatike e të cilët pas kthimit duhet të sistemohen në po të njëjtat pozita.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.356/2021

Ardita Perçuku-SHYTI

Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit;
- Sekretarit te Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

